



DREJTORIA E FINANCAVE, EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT

05-Nr 400-5002/2018.

Klinë Dt: 19/07/2018.

Në mbështetje të Ligjit Për Vetqeverisje lokale në Kosovë nr.03/L-040, nenit 91 të Statutit të Komunës së Klinës, Drejtori i Drejtorisë Për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim I KK të Klinës lëshon këtë:

NJOFTIM-VREJTJE E FUNDIT

Gjatë këtijë viti ky është njoftimi I tretë më radhë që do të jetë njëherit vajtja e fundit që u drejtohet gjith obliguesve ndaj taksave komunale mbi bazën e taksës për ushtrimin e veprimtarisë afariste, qirasë për shfrytëzimin e lokaleve dhe banesave në pronësi të komunës që kanë obligime të pa paguara në vlerë mbi 1.000,00€, të cilave gjatë këtijë viti u janë shpërndarë vajtjet për mos pagesë të obligimeve, se duke filluar nga data 01.08.2018, jemi të detyruar të fillojmë procedurat përmbaremore për inkasimin e detyrueshëm të obligimeve që do të bërt më veti edhe shpenzime procedurale shitesë.

Të gjithë obliguesit, të cilët dëshirojnë të ikin procedurave përmbaremore, këtë mund ta bëjnë duke paguar fillimisht pjesën e obligimit mbi 1.000,00€, dhe duke bërë Marrëveshje për pagesë më kiste për vlerën e mbetur nënë 1.000,00€.

Afati për ta bërë këtë pagesë skadon më 01/08/2018.

Gjithëashtu obliguesve të tatimit në pronë që kanë poashtu obligime mbi 1.000,00€, fillimisht do të shpërndahen Vajtjet e fundit siq parashihet më Ligjin e Tatimit në Pronën e Pa lujtshme, dhe pas afatit prej 10 ditësh do të fillojnë procedurat për inkasim të detyrueshëm, konformë procedurave të Ligjit Mbi Tatimin në Pronën e Palujtëshme.

Për obliguesit e tatimit në Pronë, të cilët mbrënda afatit prej 10 ditëve sa zgjatë Vajtja e Fundit përmbushen obligimet e tatimit në pronë për vlerën mbi 1.000,00€, për pjesën tjetër të obligimit kanë mundësi të bëjnë marrëveshje për pagesë më kiste për në afat maksimum deri në 12 muaji.

Në fazën e ardhëshme aktiviteti për inkasim të detyrimeve të obliguesve do të vazhdojë edhe më obligimet që kanë obligime nën 1.000,00€.

Me respekt



Drejtori,

Aziz Desku